



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 07/02  
Datë: 02.03.2011

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 9.2 të Ligjit për Ndërmarrjet Publike dhe paragrafit (3) të nenit 4 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 2 mars 2011, mori:

**V E N D I M**

1. Ndryshohet Vendimi 02/41 datë 23.10.2008 për themelimin e Komisionit Ndërministror që të analizojë opsionet për participimin e sektorit privat në PTK Sh.A duke përfshi edhe privatizimin eventual të të gjitha apo disa njësive të biznesit të PTK Sh.A.
2. Komisioni përbehet nga:
  - 1.1 Z. Besim Beqaj, Ministër i Zhvillimit Ekonomik, Kryesues;
  - 1.2 Znj. Mimoza Kusari Lila, Ministre e Tregtisë dhe Industrisë, anëtare;
  - 1.3 Z. Fehmi Mujota, Ministër i Infrastrukturës, anëtar;
  - 1.4 Z. Nenad Rashi, Ministër i Punës dhe Mirëqenies Sociale, anëtar;
  - 1.5 Z. Bedri Hamza, Ministër i Financave, anëtar;
3. Komisioni Qeveritar të ndjekë një procedurë të hapur, transparente dhe konkurruese ne përputhje me kushtet procedurale të parapara me ligjet e Republikës së Kosovës dhe me standardet më të larta ndërkombëtare.
4. Komisioni do t'i rekomandojë Qeverisë së Republikës së Kosovës opsionet e mundshme të (privatizimit eventual ) të PTK-së sh.a.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë